

KONTRATË THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Tamushi” Sh.P.K.

Sot me datë 05.01.2020, Xarrë-Sarandë, me vullnetin tonë të lirë, ne të nënshkruarit:

- Nikolla Tamushi, i biri i Dhimitri, i datëlindjes 09 Shator 1983, lindur në Xarrë-Sarandë dhe banues në Xarrë-Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.038414159 dhe numër personal I30909043U me datë lëshimi 27/09/2019
- Kristaq Tamushi, i biri i Dhimitri, i datëlindjes 16 Prill 1981, lindur në Sarandë dhe banues në Xarrë-Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.034714574 dhe numër personal I10416055P me datë lëshimi 27/09/2019
- Ilia Tamushi, i biri i Dhimitri, i datëlindjes 11 Tetor 1988, lindur në Xarrë-Sarandë dhe banues në Xarrë-Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.035198350 me numër personal I81011051B me datë lëshimi 02/12/2019

ne zbatim të Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” ,

Neni 1

Vendosem të themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“Tamushi” shpk.**

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Përpunim i qumështit dhe prodhimi i nënprodukteve të tij
- Tregëti me shumicë dhe pakicë
- Import Eksport i lëndëve të para dhe makinerive

Neni 3

Ortakt themelues të shoqërisë janë: z. Nikolla Tamushi dhe z. Kristaq Tamushi dhe z. Ilia Tamushi.

Neni 4

Shoqëria mund të ushtroje çdo veprimtari tjetër tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohej me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 lekë (dhjetëmijë) dhe përbëhet nga 3 (tre) kuota, e ndarë si më poshtë:

1. Nikolla Tamushi, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 3,400 (tremijë e katërqind) lekë, ose 34% të kapitalit themeltar
2. Kristaq Tamushi, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 3,300 (tremijë e treqind) lekë ose 33% të kapitalit themeltar
3. Ilia Tamushi, kontribuon me 1 (një) kuota prej 3,300 (tremijë e treqind) lekë ose 33% të kapitalit themeltar.

Neni 7

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në fshatin Xarre, Rruga Xarre-Butrint, Godina No.1, Xarre-Sarandë.

Neni 8

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 9

Administrator i shoqërisë është z. Nikolla Tamushi, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "Tamushi" SH.P.K.

Nikolla TAMUSHI _____

Kristaq TAMUSHI _____

Ilia TAMUSHI _____